



REPUBLICA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



VENDIM

Nr. 109 Datë 31.07.2012

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË METODOLOGJINE E LLOGARITJES SE DEMIT EKONOMIK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 pika 14, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.07.2012, mbasi shqyrtoi kërkesen e CEZ Shpërndarje dhe relacionin e përgatitur nga ana e Drejtorive Teknike për disa ndryshime në Metodologjinë e Llogaritjes së Demit Ekonomik,

Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimet në Metodologjinë e Llogaritjes së Demit Ekonomik. (Ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shpërndarje sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletore Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLICA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 109, Datë 31 .07.2012

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË METODOLOGJINE E
LLOGARITJES SE DEMIT EKONOMIK**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Sokol Ramadani	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____



REPUBLICA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

Teksti i ndryshimeve

Ndryshimet ne Metodologjinë e Llogaritjes se Demit Ekonomik, miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionerëve nr. 109 date 31.07.2012

Ne piken 4 behen keto ndryshime:

Demi ekonomik eshte vlera korrespondues ne Leke e sasise se energjise elektrike (kWh) te konsumuar mesatarisht gjate nje periudhe prej 1.5 vjetesh prej nje konsumatori/klienti tipik te seciles kategori.

Në asnjë rast vlera korresponduese në energji e demit ekonomik të llogaritur nuk do të merret në konsideratë për llogaritjen e bilancit energjistik të kompanisë CEZ Shpërndarje sh.a.

Sasia e energjise se konsumuar eshte llogaritur si produkt i konsumit mujor te nje konsumatori/klienti tipik, te kategorise ku shkaktari i demit ben pjese, me numrin e muajve te 1.5 vjeteve (18) dhe percaktohet ne tabelen e meposhtme:

Grupi I Klienteve		A	Demi Ekonomik ne Leke
Familjare	Nje Fazor, Tre Fazor	10-40	81,000
Jo familjare	Nje fazor	25	202,500
Jo familjare	Tre Fazor	40	405,000
Jo familjare	Tre Fazor	63	637,875
Jo familjare	Tre Fazor	80	81 000

Jo familjare	Tre Fazor	100 - 120	1,215,000
Jo familjare	TM	1 kva	13,500

Per llogaritjen e vleres se Demit Ekonomik sasia mesatare e konsumit per cdo kategori klientesh eshte shumezuar me cmimin me te larte te shitjes se energjise elektrike per klientet tarifore te miratuar nga Bordi i Komisionereve i ERE-s.